



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4822/21 datë:23.02.2021



Npi – 01/45 datë: 04.03.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) si dhe nenin 58 pika (j) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 46.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, si dhe mbi bazën e prezentimit të raportit vjetor financiar për vitin 2020 nga Zyra për Financa, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 04.03.2021, nxori këtë:

V E N D I M

**PËR APROVIMIN E RAPORTIT FINANCIAR TË KOMUNËS SË SHTIMES
PËR VITIN 2020**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 04.03.2021, me shumicën e votave aprovoi, Raportin Financiar të Komunës së Shtimes për vitin 2020.

II

Raporti financiar për vitin 2020, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj